



PSH.nr.839/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk- Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Valoni Impex” Shpk – Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian” me nr. prokurimi 632-20-4704-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Gjakovë, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit të operatoreve ekonomik: OE: “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk- Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian” me nr. prokurimi 632-20-4704-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian” me nr. prokurimi 632-20-4704-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK Gjakovë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk - Rahovec, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk- Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 22.10.2020 me nr. 839/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian” me nr. prok: 632-20-4704-1-2-1 iniciuar nga autoriteti kontraktues - KK Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 72 i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 02.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE “Partners”Shpk & “AGE Group”Shpk, se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në disa pozicione keni ofruar çmime të larta ndërsa në shumicën e pozicioneve tjera keni ofruar çmime jo-normalisht të ulëta, që sipas OE ankues AK ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët duke mos kërkuar sqarime konform neneve të lartcekura ,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (B42) të datës 08.10.2020 për grupin e OE “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk thuhet: Ju si Operator Ekonomik në disa pozicione keni ofruar çmime shumë të larta

në krahasim me çmimin e tregut (Bllok gjysmëgiter 19cm x 19cm x 25cm ose të ngjashëm, bllok gjysëm giter 12cm x 20cm x 25cm/ose të ngjashëm, armatur Ø12 12m', armatur Ø6 12m', tjegulla prej argjile të pjekura kualitetit të lartë" Cakto tipin dhe sa copë/ m² dhe kabëll ajrore 4x16mm dhe në shumicën e pozicioneve keni ofruar çmime jo-normalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurën e çmimit për njësi sipas çmimit të poentuar/peshuar.

Bazuar në interpretimin e KRPP-së dhe vendimit të OSHP-së, PSH.nr.590/19 të datës 13.11.2019, eksperti shqyrtues sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar duhet të eliminohet nga praktika kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e një ofertuesi tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuar të bazohen në çmimet e ofrura, e jo duke u bazuar në çmimet e ofertuesve të tjere, sepse në rast se kemi të bëjmë me krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët dhe gjen zbatim rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët. Eksperti shqyrtues sqaron se Neni 52.6 i LPP-së përcakton: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose edhe në rast të kontratave për çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyre që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet "çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm"

Eksperti shqyrtues sqaron se në rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë. Psh. nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport.

Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj në mënyre të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-së, kjo në bazë të interpretimit të KRPP-së të datës 10.12.2019 tek pyetjet e shpeshta, pyetja nr.68.

Konsideroj që AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform procedurës së përcaktuar sipas çmimit për njësi të poentuar dhe interpretimit të KRPP-së, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk, se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në disa pozicione keni ofruar çmime të larta ndërsa në shumicën e pozicioneve tjera keni ofruar çmime jo - normalisht të ulëta, që sipas OE ankues AK ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, duke mos kërkuar sqarime konform neneve të lartcekura.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (B42) të datës 08.10.2020 për grupin e OE “Partners” Shpk & “AGE Group” Shpk thuhet: Ju si Operator Ekonomik në disa pozicione keni ofruar çmime shumë të larta në krahasim me çmimin e tregut (Bllok gjysmëgiter 19cm x 19cm x 25cm ose të ngjashëm, bllok gjysmëgiter 12cm x 20cm x 25cm/ose të ngjashëm, armatur Ø12 12m', armatur Ø6 12m', tjegulla prej argjile të pjekura kualitetit të lartë” Cakto tipin dhe sa copë/ m² dhe kabëll ajrore 4x16mm dhe në shumicën e pozicioneve keni ofruar çmime jo-normalisht të ulëta.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurën e çmimit për njësi sipas çmimit të poentuar/peshuar. Bazuar në interpretimin e KRPP-së dhe vendimit të OSHP-së PSH.nr.590/19 të datës 13.11.2019, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar duhet të eliminohet nga praktika kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e një ofertuesi tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuar të bazohen në çmimet e ofruara, e jo duke u bazuar në çmimet e ofertuesve të tjerë sepse në rast se kemi të bëjmë me krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët dhe gjen zbatim rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se neni 52.6 i LPP-së përcakton: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose edhe në rast të kontratave për çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet

“çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë. Psh. nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport.

Për fund, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj në mënyre të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-së, krejt kjo në bazë të interpretimit të KRPP-së të datës 10.12.2019 tek pyetjet e shpeshta, konkretisht pyetja nr.68.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk e ka bërë vlerësimin e tenderëve konform procedurës së përcaktuar sipas çmimit për njësi të poentuar dhe interpretimit të KRPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të veproj në harmoni me dispozitat e LPP-së dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhî PAÇARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK KK Gjakovë;
- 1x1 OE "PARTNERS" SHPK & "AGE GROUP" SHPK- Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.